



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I KONTABILISTËVE TË MIRATUAR**  
**RREGULLORE**  
**Nr. 3, datë 01.02.2007**  
**FINKSIONIMIN E DEGËS DHE TË SEKSIONIT TË IKM-së**

Bazuar në nenet 16 dhe 27 të Statutit të IKM, me qëllim që të rregullojë funksionimin e organeve drejtuese të degeve e seksioneve të tij në rrethe, Këshilli i Drejtimit i Institutit të Kontabilistëve të Miratuar harton këtë Rregullore

**1. Krijimi i Seksioneve dhe Degëve**

Në varësi të numrit dhe prirjes drejt rritjes, në të dy kategoritë e anëtarësisë në IKM, (a) anëtarë me të drejta të plota dhe (b) kandidatë aspirantë (aplikantë) për të fituar titullin “Kontabël i Miratuar”, në rrethe mund të ngrihen e të funksionojnë seksione ose degë.

Degët dhe/ose Seksionet krijohen në cdo rreth apo grup rrëshesh, me miratimin e Këshillit të Drejtimit.

Në ato rrethe ku ka mbi 20 anëtarë dhe ky numër ka tendencë të rritet mund të krijojen degë të IKM-së, ndërsa në ato rrethe ku numri i anëtarëve nuk i kalon 20 vetë mund të krijojen seksione të IKM-së. Vec kësaj, disa seksione që kanë afersi gjeografike, duke u bashkuar me njëri tjeterin, mund t'i kërkojne Këshillit të Drejtimit të IKM-së miratimin e krijimit të deges ose seksionit për rajonin gjeografik.

**2. Organet drejtuese të Degës e Seksionit**

Organit drejtues më i lartë i Degës është Mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të degës. Kryesia e Degës drejton Degën në periudhën midis dy mbledhjeve të përgjithëshme të zakonshme të anëtarëve. Ai përbëhet nga 5 anëtarë të zgjedhur nga mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të degës, me një mandat 4 vjetësh me të drejte rizgjedhje vetëm një herë, sipas të njëjtave modalitetë që përdoren edhe për zgjedhjen e anëtarëve të KD të IKM.

Organit Drejtues më i lartë i seksionit është mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të seksionit. Kryesia e Seksionit drejton seksionin në periudhën midis dy mbledhjeve të përgjithëshme të zakonshme të anëtarëve të seksionit. Ai përbëhet nga 3 anëtarë të



# Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqiperisë

## Albanian Institute of Certified Accountants

zgjedhur nga mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të seksionit, me një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhje vetëm një herë, sipas të njëjtave modalitetë që përdoren edhe për zgjedhjen e anëtarëve të KD të IKM-së.

2/1. Dorheqja, Revokimi, Largimi i një anëtarit të kryesisë së Degës ose Seksionit dhe procedurat e zëvëndësimit të tij.

Në raste dorëheqje, vdekje ose çdo raste tjeter të pengimit të kryerjes së funksionit të anëtarëve të kryesisë së Degës ose Seksionit, me propozim të kësaj të fundit dhe me miratim te KD te IKM –së, në funksionin e lire caktohet deri në zgjedhjet e ardhëshme një anëtar i Degës ose Seksionit i cili në zgjedhjet e fundit pararendese ka fituar numrin më të madhë të votave si kandidatë, por që nuk është zgjedhur në kryesinë e Degës ose Seksionit. Në mbledhjen më të afërt të anëtarësisë të Degës ose Seksionit vendoset të aprovohet ky caktim ose të vendoset që zëvëndësimi të bëhet me zgjedhje. Në rastet kur numri i vendeve të anëtarëve të kryesisë së Degës/Seksionit që mbeten të lira për shkaqet e sipërpermendura është më i madh se 3/5 për degët dhe 2/3 për Seksionet atëhere bëhen zgjedhje e reja për kryesinë e Degës ose Seksionit.

Për rastet e revokimit ose të largimit të një anëtarit të kryesisë së Degës ose Seksionit përmos realizim të detyrave në funksionin që mban, propozimi për largimin e tij bëhet nga:

- Kryetari i Degës ose Seksionit
- Nga 1/10 e anëtarësisë me të drejtë vote në momentin e propozimit
- Nga 2/3 e kryesisë së Degës ose Seksionit
- Këshilli i Drejtimit të IKM

Në propozim të jepen qartë dhe me argumente arsyet e kërkesës për largimin e anëtarit nga kryesia e Degës/Seksionit. Miratimi i propozimit të largimit, revokimit të një anëtarit të kryesisë bëhet nga KD i IKM-së. Procedurat për miratimin e këtij vendimi dhe zëvendësimit të anëtarit të kryesisë së Degës/Seksionit të larguar, revokuar janë të njëjta me ato të rasteve të mësipërme.

### 3. Mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve të degës e seksionit

Mbledhja e përgjithëshme e anëtarëve (asamblesë) së degës ose seksionit bëhet paktën një herë në vit, brenda gjashtë majorit të parë të vitit pasardhës, për të shqyrtau e vendosur mbi veprimtarine vjetore të kryesisë së degës ose seksionit.

Ajo mblidhet gjithashtu sa herë që gjykohet e nevojshme, kur një gjë e tillë kërkohet nga të paktën 1/10 e anëtarëve të degës e seksionit, nga jo më pak se 2/3 e anëtarëve të kryesisë së degës e seksionit, ose me vendim të këshillit të drejtimit të IKM.

Në mbledhjen e përgjithëshme të anëtarëve të degës mund të marrin pjesë deri në dy anëtarë të Këshillit të Drejtimit, të caktuar nga Këshilli i Drejtimit i IKM-së.





## Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqiperisë Albanian Institute of Certified Accountants

### 4. Rendi i ditës i mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të degës e seksionit

Rendi i ditës i mbledhjes të përgjithshme të anëtarëve të degës e seksionit, caktohet nga autorि/(ët) e thirrjes, i cili (te cilët), njoftojnë kryetarin e kryesisë të degës e seksionit per të organizuar komunikimin pér anëtarët, të paktën 10 ditë para datës së mbledhjes. Autorи (ët) e thirrjes së mbledhjes së përgjithshme të degës / seksionit, në të njëjtën kohe njoftojnë edhe sekretarinë e I K M –së, ku dërgohet edhe kopja e rendit të ditës së mbledhjes.

Në komunikimin e rendit të ditës duhet të percaktohet vendi, data e ora e mbledhjes. Në raste urgjente afati i komunikimit mund të jetë deri në jo me pak se 4 (katër) ditë para mbledhjes.

Këshilli i Drejtimit i IKM-se mund të kërkojë që asambleja e degës dhe seksionit të trajtojë edhe cështje të tjera me interes pér profesionin dhe organizimin e institutit.

### 5. Ndarja e funksioneve të organeve Drejtuese të Degëve e Seksioneve

Funksionet e organit drejtues të degës përbëhen nga kryetari, zv/kryetari dhe tre anëtarë. Zgjedhja e kryetarit dhe zv/kryetarit bëhet nga mbledhja e kryesisë së degës

Funksionet e organit drejtues të seksionit përbëhen nga përgjegjësi i seksionit dhe dy anëtarë. Zgjedhja e kryetarit bëhet nga mbledhja e kryesisë së seksionit

Kryesitë e degëve dhe seksioneve bëjnë ndarjen e detyrave sipas funksioneve jo më vonë se 1 javë pas zgjedhjes së tyre dhe njoftojnë me shkrim Këshilllin e Drejtimit të IKM-së

Në funksionet që do të mbulohen nga anëtarët e kryesive përfshihen (a) anëtarësimet e reja (b) mbajtja e regjistrat të anëtarëve e kandidatëve të aktualizuar (c) organizimi i punës pér kualifikimin pér hyrjen në profesion dhe kualifikimin e vijueshëm (d) praktikat profesionale dhe të etikës, disiplinës e investigimit (e) administrimi financiar e buxhetit; si edhe cdo cështje tjetër që gjykohet e nevojshme pér një degë apo seksion të caktuar, duke bërë kujdes që theksi të vendoset në ato aspekte që janë të rëndësishme

Kryetari i degës apo seksionit kryeson mbledhjen e degës dhe seksionit. Ai është anëtar i Këshillit të Kryetarëve të degëve dhe të seksioneve që është organ këshillues i Këshillit të Drejtimit pér probleme që janë parashikuar në statutin e IKM-së.

Kryesia e Degës /Seksionit harton rregullore të vecantë, ku përcakton kryerjen e detyrave specifike nga cdo anëtar i kryesise

### 6. Veprimtaria e organeve drejtuese të degëve e seksioneve

Veprimtaria e organeve drejtuese të Degëve ose të Seksioneve bazohet në statutin e IKM-së, në vendimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, në vendimet e udhëzimet specifike të Këshillit të Drejtimit të IKM.

Kryesia e degës / seksionit mblidhet të paktën një herë në tre muaj, ku analizon cështje të ndryshme bazuar në programin e punës së saj, udhëzimet e dhëna nga Këshilli i Drejtimit



i IKM-së, dhe të tjera që i interesojnë profesionit.

Për datën dhe rendin e dites të mbledhjes së kryesisë të degës/seksionit njoftohet edhe Këshilli i Drejimit të IKM-se, i cili mund të dërgojë për të qënë i pranishëm njërin nga anëtarët e tij. Rezutatet – vendimet dhe konkluzione të tjera të mbledhjes i dërgohen me shkrim, me firmën e kryetarit të mbledhjes, brenda 10 ditëve nga përfundimi i mbledhjes KD të IKM-së.

Kryesia e Degës / Seksionit bazuar në programin vjetor të punës të Këshillit të Drejimit të IKM-së, si edhe në specifikat e degës apo seksionit (por pa u kufizuar vetëm në to) kryen këto detyra:

- harton programin vjetor të punës,
- bën propozime për cështje që ajo mendon se duhet të përfshihen në
  - o programet e kualifikimit profesional të kandidatëve,
  - o kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve,
  - o procedurat që duhet të ndiqen për shtimin e numrit të anëtarëve dhe kandidatëve.
- Organizon evidentimin dhe mbledhjen e kuotave të anëtarësisë brenda afateve të caktuara.
- Organizon regjistrin e anëtarëve, sipas udhëzimeve të dhëna nga seksretaria e IKM-së, ku përvec të dhënavë personale, evindetohet Nr i Regjistrit Themeltar të anëtarësisë IKM, që jepet nga Sekretaria e IKM-së.
- Organizon mbledhjet e përgjithëshme të Degës ose Seksionit sa herë që ato thirren në pajtim me pikën 3 të kësaj rregullore
- Në bashkëpunim me strukturën ekzekutive dhe KD e IKM-se organizon kualifikimin e vijueshëm të anëtarëve dhe kandidatëve
- Organizon punën për mbajtjen e regjistrave të veprimtarisë profesionale të anëtarëve të seksionit dhe koordinon punën me KD të IKM-së për kontrollin e mbajtjes së tyre dhe për kontrollin e cilësisë së punës të anëtarëve të IKM-së.
- Mban lidhje me organizmat private ose shtetërore të zonave ku operon në zbatim të marreveshjeve që ka IKM.
- Kryen detyra të tjera, në pajtim me statutin e IKM-së dhe këtë rregullore

## 7. Raportimi e informimi i IKM-së

Kryesia e degës/seksionit i dërgon informacione periodike të paktën një herë në tre muaj Këshillit të Drejimit të IKM-së, si dhe për cështje specifike edhe me shpejt, në lidhje me veprimtarinë e kryesisë. Në informacionin që dërgohet bëhet një përbledhje e konkluzioneve të mbledhjes së organit drejtues dhe i masave që janë marrë për periudhën



## Instituti i Kontabilistëve të Miratuar të Shqiperisë Albanian Institute of Certified Accountants

e ardhëshme tre ose 6 mujore.

Kryesia e degës / seksionit rakordon me Sekretarinë e IKM-së lidhur me shlyerjen e detyrimeve të anëtarësisë (kuotave) dhe brenda datës 10 të muajit pasardhës dërgon informacion mbi arkëtimet dhe anëtarësimet e reja.

Në IKM dërgohen dokumentat origjinal te anëtareve te rind, dhe lista e anëtareve që kanë shlyer pagesën e kuotave.

Kryesia e degës / seksionit grumbullon evidencat e raportimit të misioneve të kryera nga anëtarët, sipas formatit dhe afateve të përcaktuar nga Këshilli i Drejtimit i IKM-së dhe i dërgon ato në IKM jo më vonë se data 15 Maj e vitit pasardhës. Mbi bazën e videncave të misioneve përcakton kuoten variable që duhet të paguajnë anëtarët e degës/seksionit të tyre. Lista me anëtarët që i nënshtrohen kuotës variabel si dhe shumat përkatëse të kuotave dergohen në IKM jo me vone se data 31 Maj.

### 8. Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi duke filluar nga data 01 Shkurt 2007

